

KOHA PËR VEPRIM MBI QËNDRUESHMËRINË: HAPAT E ARDHSHËM PËR PROFESIONIN E KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT

Me themelimin e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Qëndrueshmërisë (BSNQ), rrugëtimi drejtë së ardhmës është i qartë: Profesionit i kontabilitetit dhe auditimit duhet të udhëheqë rrugëtimin drejtë raportimit mbi çështjet klimatike dhe çështje të tjera materiale mjedisore, sociale dhe të qeverisjes dhe sigurinë e tyre - duke kontribuar në tregje dhe ekonomi të fuqishme dhe të qëndrueshme financiare dhe duke mundësuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së.

VEPRIMET

- 1** Avokoni mbi rregullimin e politikave që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë — duke filluar me mbështetjen e BSNQ dhe duke kërkuar siguri mbi çështjet e qëndrueshmërisë.
- 2** Përvetësoni një mentalitet të integruar brenda kompanive duke zbrërthyer informacionet jashtë kornizës dhe promovoni një qasje të ndërlidhur ndaj asaj që kompanitë raportojnë dhe kanë siguruar.
- 3** Jeni pro-aktiv në raportimin mbi çështjet klimatike—në përputhje me kërkesat ekzistuese të standard-vënësëve dhe praktikat më të mira.
- 4** Demonstroni aftësi dhe kompetenca që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë—duke siguruar që kontabilistët dhe auditorët profesionistë të vazhdojnë të zgjerojnë shërbimet me vlerë të shtuar që mund të ofrojnë në të ardhmen.

PËRSHPEJTIMI I QËNDRUESHMËRISË

Adresimi mbi krizat klimatike

Promovimi i organizatave të qëndrueshme që krijojnë vlerë afatgjatë për investitorët, palët e interesuara dhe shoqërinë

Krijimi i mundësië për entitetet raportuese dhe investitorët të masin dhe vlerësojnë progresin drejt qëndrueshmërisë

OBJEKTIVI

MUNDËSIMI I INFORMACIONEVE ME CILËSI TË LARTË DHE TË DOBISHME PËR VENDIMMARRJE

SHMANGNI FRAGMENTIMIN RREGULLATOR

Për të promovuar qëndrueshmërinë dhe krahasueshmërinë për investitorët dhe tregjet e kapitalit

Për të reduktuar koston, kompleksitetin dhe konfuzionin për entitetet raportuese



Mbështetni dhe promovoni BSNQ - profesioni i kontabilitetit dhe auditimit është një akter relevant esencial

- Rrugëtimi drejt qëndrueshmërisë globale së krahasueshme, dobishme për vendimmarrje dhe të garantueshme fillon me një bazë gjithëpërfshirëse të standardeve të vendosura nga BSNQ. **Ky është Blloku 1 i qasjes:** informacioni i përqendruar te investitorët.
- Profesionit i kontabilitetit dhe auditimit duhet të inkurajojë dhe të kontribuojë në plotësimin e standardit për çështje klimatike të BSNQ në vitin 2022, me miratimin e mundshëm nga IOSCO. Ky është hapi i parë në misionin e BSNQ për të zhvilluar standarde që adresojnë një gamë të gjerë faktorësh mjedisor, social dhe të qeverisjes.
- Tani është koha për t'u angazhuar me politikëbërësit dhe rregullatorët lokal mbi ndërtimin e sukseshëm për miratim të Standardeve të Ndërkombëtare për Raportim Financiar (SNRF) dhe për të zhvilluar **një rrugë të ngjashme për Standardet e Shpalosjes së Qëndrueshmërisë SNRF.**
- Politikëbërësit duhet të bashkëpunojnë dhe të harmonizojnë kërkesat specifike të juridiksionit me kërkesat globale të zhvilluara nga BSNQ.





- **Informacion dhe të dhëna:** Kontabilistët dhe Auditorët janë në qendër të rrjedhës së informacionit dhe vendimmarrjes—të pozicionuar në mënyrë unike për të kapur, analizuar, raportuar dhe siguruar informacionin mbi qëndrueshmërinë.
- **Aftësitë dhe kompetencat përkatëse:** Duhet të ndodhë ndërlidhja e informacionit financiar dhe të qëndrueshmërisë. Kjo mbështetet në aftësitë dhe kompetencat e kontabilistëve dhe auditorëve – duke kombinuar të kuptuarit e modelit të biznesit të një kompanie, rreziqet/mundësitë, sistemet/proceset dhe performancën me njohuritë e faktorëve të qëndrueshmërisë dhe aftësinë për të bashkëpunuar me ekspertë.
- **Arritja globale:** Kontabilistët dhe Auditorët janë të lidhur globalisht për të përmbushur nevojat e tregjeve globale të kapitalit, klientëve globalë dhe zinxhirëve të furnizimit global.
- **Sigurimi i cilësisë së lartë:** Shërbimet e Sigurimit, bazuar në ISAE 3000 (i rishikuar) i BSNAS/IAASB - i aplikuar nga kontabilistët dhe auditorët në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë dhe një kornizë etike - rrit besueshmërinë në shpalljet për qëndrueshmërinë. Sigurimi i qëndrueshmërisë me cilësi të lartë duhet të jetë i detyrueshëm.
- **Mandati i interesit publik:** Si një profesion i rregulluar, kontabilistët dhe auditorët i nënshtrohen një kodi etik, mbikëqyrjes publike dhe ngarkohen të veprojnë në interes të publikut. Gjykimi dhe skepticizmi i tyre profesional, pavarësia dhe kompetencat janë unike.

SI

AVOKO PËR POLITIKA DHE RREGULLORE TË DUHURA

Përmirësoni raportimin e korporatave përmes kornizave rregullatore që nxisin rregullësi dhe përcaktojnë qëllimin e asaj që kompanitë raportojnë dhe ofrojnë, duke dekurajuar sjelljet e bazuara në pajtueshmëri.

Nxit besimin dhe konfidencialitetin në raportin e informacionit të qëndrueshmërisë së kompanive duke kërkuar siguri të cilësisë së lartë, të kryer në përputhje me standardet e përcaktuara nga BSNAS/IAASB dhe të kryera nga kontabilistët dhe auditorët.

Zbatoni kërkesat e qëndrueshmërisë duke marrë një qasje proporcionale, me faza, e cila është e drejtë për ndërmarrjet më të vogla.

Përditësoni regjimet e përgjegjësive për të mbështetur më mirë shërbimet profesionale të zgjeruara dhe me vlerë të shtuar.

DEMONSTRO AFTËSI DHE KOMPETENCA TË LIDHURA ME QËNDRUESHMËRINË

Poziciononi kontabilistët dhe auditorët si profesionistët që më së miri të përmbushen nevojat e entiteteve raportuese lidhur me qëndrueshmërinë, duke përfshirë shërbimet e sigurimit.

Integrioni çështjen e qeverisjes mjedisore, sociale dhe të korporatave (ESG) me aftësitë dhe kompetencat themelore, gjykimin profesional dhe integritetin e kontabilistëve dhe auditorëve.

Ofroni mbështetje, edukim dhe udhëzime teknike që promovojnë raportim me cilësi të lartë dhe siguri të informacionit të qëndrueshmërisë, duke rritur rolin e kontabilistëve dhe auditorëve si partnerë dhe këshilltarë të çmuar.

JENI PROAKTIV MBI RAPORTIMIN E QËSHTJEVE KLIMATIKE

Jeni në pajtueshmëri me kërkesat e raportimit të pasqyrave financiare (p.sh., Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) ose standardet lokale dhe praktikatat më të mira), pa lëshime materiale ose anomali për të pasqyruar çështjet klimatike materiale në performancën financiare

Përafroni dhe integrioni informacionet e lidhura me çështjet klimatike dhe shpalljet financiare me angazhimet/objektivat dhe vendimet strategjike të deklaruara të një entiteti ekonomik raportues.

Përcaktoni sasinë e rreziqeve të lidhura me çështjet klimatike dhe ndërtoni sisteme të fuqishme të identifikimit dhe raportimit të të dhënave për informacionet mbi qëndrueshmërinë.

PËRFEKSIONONI MENDIMIN E INTEGRUAR

Përmirësoni qeverisjen e korporatave, duke përfshirë komitetet e auditimit, për të ofruar mbikëqyrje efektive të të gjithë raportimit, duke përfshirë shpalljen e lidhur me qëndrueshmërinë.

Eliminimi i informacionit të izoluar brenda kompanive për të integruar më mirë shpalljet e qëndrueshmërisë me ndihmën e Drejtorëve Financiar dhe për të lehtësuar vendimmarrjen dhe komunikimin holistik me palët e interesuara.

Konsideroni me kujdes çështjet klimatike dhe faktorët e tjerë të qeverisjes mjedisore, sociale dhe të korporatave (ESG)—duke i integruar ato në zhvillimin e strategjisë dhe modelit të biznesit, vendimmarrjen dhe vlerësimet e rreziqut/mundësisë.